



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 425/1 prot.

Tiranë, më 29.05.2019

VENDIM

Nr.50, datë 29.05.2019

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 79, DATË 21.09.2018, NË
INSTITUCIONIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Nr. 79, datë 21.09.2018 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Urdhrin *nr. 28 datë 18.02.2019*, “*Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë*”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 79, datë 21.09.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues me nr. 79, datë 21.09.2018, për rregullimin e ligjshmërisë, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport dhe në detyrat e lëna për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar në subjekt veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë që të rregullohet ligjshmëria e marrëdhënies së punësimit për punonjësen *****, duke krijuar kushtet për ndjekjen e trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA, pasi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo nëpunëse ka qenë e emëruar në pozicion të shërbimit civil për një periudhë më pak se një vit.

Nga shqyrtimi i dokumentacioni të administruar nga grupi i punës, vërej se nëpunësja *****, ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA, për periudhën 12-23 Nëntor 2018, në përfundim të të cilit i është nënshtruar testimit dhe rezulton të jetë vlerësuar me 24 pikë, nga 28 pikë të mundshme.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit është zbatuar drejt detyrimi i lënë në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 79, datë 21.09.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve edhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.79, datë 21.09.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA